



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 32/8 prot.

Datë 26.01.2026

V E N D I M

Nr. 136/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 26.01.2026, shqyrtoi çështjen me:

- Objekt:** Vendim për mbylljen e çështjes mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Eduart Xhixha” PF në procedurën e prokurimit “*E hapur e thjeshtuar*”, me nr. REF-65957-10-21-2025, me objekt: “*FV mobileri pajisje në ambientet e brendshme të MZSH*”, me fond limit 1,582,750 lekë pa TVSH zhvilluar me datë 03.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.
- Ankimues:** Operatori Ekonomik “Eduart Xhixha” PF, me NUIS L54424205B me adresë: Ndertese private, 2 kateshe, kati pare mbi toke, zona kadastrale nr. 3096, me numer pasurie 97/32/1, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Durrës, me adresë: Sheshi “Liria”, Qyteti Durrës.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar; Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”; Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë

5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlëra limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 22.10.2025, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me nr. REF-65957-10-21-2025, me objekt: “FV mobileri pajisje në ambientet e brendshme të MZSH”, me fond limit 1,582,750 lekë pa TVSH zhvilluar me datë 03.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

II.2. Në datën 11.12.2025, KVO-ja ka përfunduar fazën e vlerësimit të ofertave si vijon:

1. “Eduart Xhixha” PF	1.227.000 lekë, kualifikuar
2. “Shaga” SHPK	1.231.200 lekë, kualifikuar
3. “Eurokadiu” SHPK	1.317.000 lekë, skualifikuar
4. “Ilir Kaso” PF	1.436.200 lekë, skualifikuar
5. “Albanian Furniture” SHPK	1.471.650 lekë, skualifikuar
6. “Ro-Al” SHPK	1.537.500 lekë, skualifikuar

Më pas operatori ekonomik “Eduart Xhixha” PF është njoftuar elektronikisht për skualifikimin e tij për arsyet e mëposhtme:

“Operatori Eduart Xhixha – Person Fizik, ne vijim te kerkeses ne SPE te dates 11.12.2025, paraqiti dokumentacionin e mesiperm, nepermjet shkreses percjellese me nr prot 11213 date 15.12.2025 marre ne dorezim ne Bashkinë Durrës me nr. regjistri 11213 date 15.12.2025, dokumentacion i cili, sipas procesverbalit te inventarizimit te dates 17.12.2025, ka parregullsi, me konkretisht: Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se dokumenti per Vërtetim Debie nga Oshee është ne kundërshtim me piken 6 te nenit 26 , vkm285 date 19.05.2021 per Miratimin e rregullave te prokurimit publik. Sipas pikes 6 neni 26 vkm 285 “Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.” Dokumenti I depozituar është fotokopje jo e njesuar me origjinalin ,noterizuar apo me vule elektronike, gjë qe bie në kundërshtim me piken 6 te nenit 26 , vkm 285. Në këto kushte, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranon si të parregullt dokumentacionin e paraqitur nga Eduart XhixhaPerson Fizik me NIPT L54424205B, me vlerë të ofertës 1,227,000 lekë, duke e skualifikuar këtë ofertues.”

II.3. Në datën 31.12.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE njoftimin e fituesit të procedurës së prokurimit.

II.4. Në datën 07.01.2026, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik, me nr. A/2026/6238, protokolluar me nr.32/2026 prot, datë 08.01.2026, i operatorit ekonomik “Eduart Xhixha” PF, për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me nr. REF-65957-10-21-2025, me objekt: “FV mobileri pajisje në ambientet e brendshme të MZSH”, me fond limit 1,582,750 lekë pa TVSH zhvilluar me datë 03.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Eduart Xhixha” PF, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.5. Bazuar në nenin 112, pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 32/1 prot., datë 09.01.2026, me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “Eduart Xhixha” PF.

Konkretisht në ankesë pretendohet si vijon:

“Kam depozituar dokumentacionin provues, përfshirë Vertetimin e Debise nga OSHEE, i cili është shkarkuar nga portali qeveritar e-Albania dhe perben dokument origjinal elektronik. Megjithatë, Komisioni i Vleresimit të Ofertave ka konstatuar se dokumenti në fjale është fotokopje e panjesuar, duke e cilesuar në kundërshtim me piken 6 të nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, dhe mbi këtë bazë ka vendosur skualifikimin e ofertes sime.

Dokumenti i paraqitur Vertetimin e Debise nga OSHEE (PER TE CILIN JAM SKUALIFIKUAR) nuk është fotokopje, por origjinal elektronik, i gjeneruar nga portali zyrtar e- Albania.”

II.6. Në datën 22.01.2026, është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 32/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor me nr.345/5 prot., datë 20.01.2026, me objekt: *“Dërgohet vendimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave (në vijim KSHA), mbi shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Eduart Xhixha” pf për procedurën me objekt ankimi: “FV mobileri pajisje në ambientet e brendshme të MZSH”*”, bashkëngjitur vendimi i KSHA-së nr.345/1 prot., datë 16.01.2026 mbi shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik *“Eduart Xhixha” pf për procedurën me objekt ankimi: “FV mobileri pajisje në ambientet e brendshme të MZSH”*, me REF-65957-10-21-2025. Referuar vendimit të KSHA-së rezulton, se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës, e ka pranuar plotësisht ankesën e operatorit ekonomik *“Eduart Xhixha” PF.*

II.7. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113, ligji Nr. 162/2020, për prokurimin publik.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, për skualifikimin e padrejtë të tij në procedurën e mësipërme të prokurimit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Referuar Vendimit të KSHA-së nr.345/1 prot., datë 16.01.2026 *“Mbi shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Eduart Xhixha” pf për procedurën me objekt ankimi: “FV mobileri pajisje në ambientet e brendshme të MZSH”*, me REF-65957-10-21-2025” rezulton se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës, e ka pranuar plotësisht ankesën e operatorit ekonomik *“Eduart Xhixha” PF.*

III.1.2. Neni 30 i LPP-së parashikon shprehimisht se:

Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i cili parashikon shprehimisht se:

1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;;

ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

Për sa më sipër, në kushtet kur operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentat e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të mbyllë çështjen, lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Eduart Xhixha” PF, për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me nr. REF-65957-10-21-2025, me objekt: “FV mobileri pajisje në ambientet e brendshme të MZSH”, me fond limit 1,582,750 lekë pa TVSH zhvilluar me datë 03.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Eduart Xhixha” PF, për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar”, me nr. REF-65957-10-21-2025, me objekt: “FV mobileri pajisje në ambientet e brendshme të MZSH”, me fond limit 1,582,750 lekë pa TVSH zhvilluar me datë 03.11.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Durrës.
2. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësimin e procedurës në zbatim të Vendimit të KSHA-së nr.345/1 prot., datë 16.01.2026 “Mbi shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Eduart Xhixha” pf për procedurën me objekt ankimi: “FV mobileri pajisje në ambientet e brendshme të MZSH”, me REF-65957-10-21-2025, dhe të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Eduart Xhixha” PF.
5. Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

